


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Shtator 2024

**Tiranë, më 17 Tetor 2024:** Në Shtator 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 31 mld lekë, duke u ulur me -8,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 36,6 %, në krahasim me Gusht 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 71 mld lekë, duke u ulur me -3,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 3,0 %, në krahasim me Gusht 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 40 mld lekë, duke u rritur me 1,5 %, krahasuar me Shtator 2023 dhe duke u ulur me -13,2 %, në krahasim me Gusht 2024.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë nëntëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 286 mld lekë, duke u ulur me -14,2 %, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 666 mld lekë, duke u rritur me 2,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 380 mld lekë, duke u rritur me 19,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shtator 2024, në uljen e eksporteve prej -8,5 %, kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -5,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,4 pikë përqindje.

**Për publikim 17/10/2024**

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2024**




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë ulur me -14,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,5 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,04 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Shtator 2024, në uljen e importeve prej -3,1 %, krahasuar me Shtator 2023, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,6 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2023**



Si nëntëmujor, importet janë rritur me 2,4 %, krahasuar me nëntëmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,3 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, etj.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Shtator 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2023 janë: Italia (22,4 %), Kosova (40,0 %), Greqia (7,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Spanja (67,0 %) etj.

Gjatë këtij nëntëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (14,2 %), Kosova (6,7 %), Greqia (22,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kina (23,4 %), SHBA (81,0 %) etj.

Në muajin Shtator 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (9,3 %), Zicra (20,1 %), Maqedonia Veriut (29,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2023 janë: Kina (13,0 %), Greqia (16,0 %), Turqia (16,5 %), etj.

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (17,5 %), Greqia (19,0 %), Gjermania (4,3 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (3,1 %), Kina (0,1 %), Spanja (3,3 %), etj

**Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2024**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 56,8 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,5 %), Kina (9,2 %), Greqia (7,3 %) dhe Turqia (7,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 57,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,8 %), Kina (8,2 %), Turqia (8,1 %) dhe Greqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shtator 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23.5	157	-1.5	-120	23.6
2001		44	19.1	190	21.0	-146	23.2
2002		47	7.7	210	10.6	-163	22.6
2003		54	14.7	226	7.4	-172	24.1
2004		62	14.0	236	4.5	-174	26.3
2005		66	6.0	262	11.1	-196	25.1
2006		77	17.6	299	14.1	-222	25.9
2007		97	25.5	376	25.8	-279	25.8
2008		113	15.8	440	16.9	-327	25.6
2009		105	-7.2	429	-2.5	-324	24.4
2010		162	54.6	478	11.4	-316	33.8
2011		197	21.9	544	13.9	-347	36.2
2012		213	8.2	528	-2.9	-315	40.3
2013		246	15.7	517	-2.1	-271	47.6
2014		256	3.8	552	6.7	-296	46.3
2015		243	-4.9	545	-1.4	-302	44.7
2016		243	0.1	579	6.4	-336	42.0
2017		273	12.1	626	8.1	-353	43.6
2018		310	13.7	641	2.4	-331	48.4
2019		299	-3.8	649	1.2	-350	46.0
2020		272	-9.0	605	-6.8	-333	44.9
2021		369	35.6	801	32.3	-432	46.1
2022		487	32.0	950	18.7	-464	51.2
2020	01 - 20	23	5.3	42	-0.4	-19	54.9
	02 - 20	25	10.6	52	3.9	-27	48.3
	03 - 20	18	-36.0	44	-20.8	-27	40.1
	04 - 20	15	-44.2	36	-36.4	-21	41.0
	05 - 20	22	-22.5	45	-24.2	-23	48.1
	06 - 20	23	-9.6	52	-2.4	-29	44.3
	07 - 20	25	-11.5	57	-5.0	-32	43.3
	08 - 20	19	-3.4	48	-6.7	-29	40.2
	09 - 20	25	1.3	52	0.5	-27	48.2
	Janar - Shtabr 20	195	-13.5	429	-10.9	-234	45.4
2021	01 - 21	24	3.1	45	8.4	-22	52.3
	02 - 21	25	-0.9	52	0.9	-27	47.4
	03 - 21	32	78.1	64	45.3	-33	49.2
	04 - 21	29	92.3	63	72.9	-34	45.6
	05 - 21	33	52.7	62	38.4	-29	53.0
	06 - 21	35	50.8	67	28.9	-32	51.9
	07 - 21	32	30.6	72	26.1	-39	44.8
	08 - 21	24	22.5	61	26.2	-37	39.0
	09 - 21	25	1.3	52	0.5	-27	48.2
	Janar - Shtabr 21	195	-13.5	429	-10.9	-234	45.4
2022	01 - 22	35	47.5	55	21.1	-20	63.6
	02 - 22	37	50.5	69	31.5	-31	54.3
	03 - 22	48	50.4	84	29.7	-36	57.1
	04 - 22	42	46.6	78	23.7	-36	54.0
	05 - 22	45	36.8	80	28.6	-35	56.4
	06 - 22	46	32.2	81	20.8	-35	56.8
	07 - 22	39	23.0	82	14.1	-42	48.3
	08 - 22	35	48.1	80	30.8	-44	44.2
	09 - 22	39	52.5	88	67.6	-49	43.8
	Janar - Shtator 22	366	88.2	695	62.1	-329	52.7
2023	01 - 23	42	20.2	58	5.8	-16	72.3
	02 - 23	38	2.8	69	1.1	-31	55.2
	03 - 23	42	-11.7	81	-3.7	-38	52.3
	04 - 23	34	-19.2	75	-3.9	-41	45.4
	05 - 23	40	-11.7	81	1.2	-41	49.2
	06 - 23	38	-17.3	75	-7.5	-37	50.7
	07 - 23	38	-4.0	71	-13.6	-33	53.7
	08 - 23	27	-21.9	68	-15.0	-40	40.6
	09 - 23	34	-12.8	73	-16.6	-40	45.8
	Janar - Shtator 23	333	-9.0	650	-6.5	-317	51.3
2024	01 - 24	30	-29.2	60	3.4	-30	49.5
	02 - 24	32	-16.1	74	6.4	-42	43.5
	03 - 24	33	-21.0	75	-7.0	-42	44.4
	04 - 24	35	1.8	75	0.6	-41	45.9
	05 - 24	35	-12.4	79	-1.6	-45	43.8
	06 - 24	35	-8.9	77	2.1	-42	45.3
	07 - 24	33	-12.0	85	21.1	-52	39.0
	08 - 24	22	-18.2	69	1.9	-46	32.6
	09 - 24	31	-8.5	71	-3.1	-40	43.3
	Janar - Shtabr 24	286	-14.2	666	2.4	-380	42.9

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milione lekë), Shtator 2024**

	Eksporte				Importe			
	Shtator 2023	Shtator 2024	Jan.- Sht. 2023	Jan.- Sht. 2024	Shtator 2023	Shtator 2024	Jan.- Sht. 2023	Jan.- Sht. 2024
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>24.911</b>	<b>21.649</b>	<b>242.902</b>	<b>202.747</b>	<b>37.464</b>	<b>36.151</b>	<b>332.386</b>	<b>341.857</b>
Austri	549	159	3.235	1.805	1.438	757	6.236	6.015
Gjermani	1.881	1.676	17.948	16.414	5.003	5.139	45.459	47.411
Greqi	1.908	1.760	22.872	17.672	4.924	5.711	42.811	50.954
Itali	16.209	12.584	144.648	124.041	15.911	14.425	144.871	140.319
Spanjë	1.090	1.820	14.611	9.730	895	886	10.278	9.941
Kroaci	195	199	3.777	3.113	1.333	494	6.620	3.788
Të tjera të BE-së	3.079	3.451	35.812	29.972	7.959	8.739	76.111	83.428
Mbretëri e Bashkuar	103	96	5.988	1.106	893	707	6.313	7.261
Kinë	1.089	1.045	6.804	8.397	7.371	8.333	69.957	69.908
Kosovë	3.645	2.186	31.164	29.078	1.017	1.460	8.531	12.154
Maqedonia e Veriut	1.028	546	13.275	9.766	1.310	928	10.418	8.937
Rusi	-	-	8	7	307	412	3.477	2.861
SHBA	275	2.869	3.232	5.848	1.645	1.845	13.107	14.800
Turqi	438	288	3.088	3.036	5.988	6.973	62.687	73.655
Ukrainë	20	219	1.045	2.72	258	213	2.939	3.143
Zvicër	144	165	3.795	1.854	1.502	1.199	10.580	6.653
Të tjera	1.943	1.665	21.951	21.25	15.547	12.797	129.848	124.416
<b>Gjithsej</b>	<b>33.596</b>	<b>30.728</b>	<b>333.252</b>	<b>285.811</b>	<b>73.302</b>	<b>71.019</b>	<b>650.242</b>	<b>665.644</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milione lekë), Gusht 2024**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2023	Shtator 2024	Jan.- Sht. 2023	Jan.- Sht. 2024	Shtator 2023	Shtator 2024	Jan.- Sht. 2023	Jan.- Sht. 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>33.596</b>	<b>30.728</b>	<b>333.252</b>	<b>285.811</b>	<b>73.302</b>	<b>71.019</b>	<b>650.242</b>	<b>665.644</b>
Ushqime. pije. duhan	3.325	3.502	41.769	38.560	12.933	12.682	108.618	117.066
Minerale. lëndë djegëse. en. el.	5.739	5.024	75.053	55.224	9.337	8.336	77.015	69.096
Produkte kimike dhe plastike	1.328	1.298	11.695	11.841	9.170	9.523	85.784	86.119
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	212	140	2.078	1.511	1.050	921	10.53	8.797
Prodhime druri dhe letre	962	846	8.469	7.445	2.558	2.262	22.446	22.259
Tekstile dhe këpucë	10.646	8.810	96.031	78.996	8.536	7.847	69.969	64.015
Materiale ndërtimi dhe metale	6.969	6.680	59.069	54.028	9.302	8.842	90.534	92.307
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	3.453	3.599	29.964	28.217	17.123	17.726	158.574	176.189
Të tjera	962	829	9.124	9.989	3.293	2.880	26.771	29.798

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Shtator 2024**

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>144.648</b>	<b>124.041</b>	<b>31.164</b>	<b>31.164</b>	<b>22.872</b>	<b>17.672</b>	<b>17.948</b>	<b>16.414</b>
Ushqim. pije duhan	11.278	10.258	4.983	4.725	3.515	3.204	1.497	1.365
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	7.623	10.497	6.224	6.405	7.902	2.614	6.121	4.665
Produkte kimike dhe plastike	4.471	4.381	3.093	3.164	814	729	39	43
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.943	1.296	7	5	32	146	9	1
Prodhime druri dhe letre	4.903	3.937	920	944	1.341	1.168	93	94
Tekstile dhe këpucë	74.816	59.348	169	129	5.247	5.842	7.392	6.892
Materiale ndërtimi dhe metale	19.399	16.188	12.835	11.135	3.173	3.191	1.111	803
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	16.112	14.230	1.684	1.571	99	185	1.429	2.238
Të tjera	4.103	3.908	1.248	1.001	750	593	257	312

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Shtator 2024**

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>144.871</b>	<b>140.319</b>	<b>69.957</b>	<b>69.908</b>	<b>62.687</b>	<b>73.655</b>	<b>42.811</b>	<b>50.954</b>
Ushqim. pije duhan	21.453	23.829	1.419	1.293	4.421	4.077	13.241	14.357
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	5.045	3.630	34	17	7.761	8.567	4.360	8.329
Produkte kimike dhe plastike	17.462	17.199	6.090	5.667	8.831	9.185	7.231	8.345
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.456	6.725	685	759	250	260	38	123
Prodhime druri dhe letre	5.036	4.523	1.553	1.507	3.413	3.576	3.007	3.034
Tekstile dhe këpucë	32.269	26.764	9.663	10.522	10.575	8.720	3.992	4.748
Materiale ndërtimi dhe metale	18.876	16.391	10.262	9.511	15.118	21.863	6.438	6.802
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	30.083	32.756	35.014	34.460	9.283	14.211	3.050	3.395
Të tjera	6.189	8.500	5.237	6.171	3.035	3.196	1.454	1.823

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri